

# ISO 9001 - Përfitimet

**Më poshtë po shpjegojmë se si standardet e sistemit të menaxhimit sipas ISO 9001 bëjnë që praktikat dhe arritjet më të fundit teknologjike të jenë të zbatueshme dhe të arritshme nga të gjitha llojet e organizatave.**

Në një organizatë të vogël mund të mos ketë një "sistem", por vetëm "mënyra jonë e të bërit të gjërave", dhe kjo "mënyra jonë" mund të mos jetë as edhe e shkruar gjëkund, thjesht është vetëm në mendjen e drejtuesit ose siç ndodh rëndom në mendjen e pronarit.

Në organizata më të mëdha, numri i punonjësve është më i madh, dhe për rrjedhojë edhe gjasat për të patur procedura, instruksione, forma apo rregjistra të shkruara janë më të mëdha. Kjo bën që, jo vetëm punonjësit "të mos i bëjnë gjërat sipas mënyrës së tyre", por dhe organizata të kryejë veprimtarinë e saj me rregulla të përcaktuara qartë dhe të strukturuar. Kjo do të thotë se **koha, mjetet financiare dhe burimet e tjera përdoren me efikasitet.**

**Për të qenë vërtet eficientë dhe efektive, organizata duhet të menaxhojë mënyrën e saj të të bërit të gjërave duke e sistematizuar atë.** Kjo bën që asgjë e rëndësishme të mos lihet jashtë vëmendjes dhe se secili ta ketë të qartë se kush është përgjegjës për të bërë çfarë, kur, pse dhe ku.

**Organizatat e mëdha ose ato me procese të komplikuar, nuk mund të funksionojnë mirë pa sistemet e menaxhimit.** Kompanitë ajrore, të automobilave, të mbrojtjes apo të pajisjeve mjeksore **në vite kanë aplikuar sistemet e menaxhimit.**

Standardet e ISO për sistemet e menaxhimit bëjnë që praktikat e mira të menaxhimit **të jenë të zbatueshme për organizatat e të gjitha madhësive, për të gjithë sektorët kudo në botë.**